Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
22 -09- 2017
Prishtinë / Priština
Nr. Br. 1764 - 2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 22.09.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin i Doracakut për Procedurat e Votimit dhe Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2017

I. Miratohet Doracaku për Procedurat e Votimit dhe Numërimit, për zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me 22 Tetor 2017.

II. Doracaku si në pikën I të këtij vendimi është pjese përbërëse e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 22.09.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština

KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE

DORACAKU
I PROCEDURAVE
TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT

ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
2017

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E SISTEMIT ZGJEDHOR — 5

SISTEMI DHE ZGJEDHJET NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 5

II. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR - 6

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE 6
KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE 6
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) 7
ANKESAT NË PROCES ZGJEDHOR 8
VËZHGUESIT DHE MEDIAT 9
TË DREJTAT E POLICISË 10
TË DREJTAT E SUBJEKTEVE POLITKE 10
PERSONELI I QENDRAVE TE VOTIMIT 10
KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV) 13

III. PËRGATITJET PËR VOTIM — 28

PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE 28
DITA E ZGJEDHJEVE 34
NË DITËN E ZGJEDHJEVE 35

IV. PROCESI I VOTIMIT (07:00-19:00) — 37

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT 37
VOTIMI I RREGULLT 37
VOTIMI ME KUSHT NË VENDVOTIM TË DYFISHTË 38
VOTIMI ME POSTË (JASHTË VENDIT) 40
VOTIMI PËR PERSONAT ME NEVOJA DHE RRETHANA TË VEÇANTA 41
VOTIMI PËR VOTUESIT E NGUJUAR NË SHTËPI DHE NË RRETHANA TË VEÇANTA 42
VOTIMI NË INSTITUCIONE 44

V. MBYLLJA E VENDVOTIMIT — 45

MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT 45
MBYLLJA E VENDVOTIMIT (19:00) 45

VI. NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPUTHJA E REZULTATEVE — 47

NUMËRIMI I ZARFEVE ME KUSHT NË VENDVOTIM TË DYFISHTË 48
NUMËRIMI I VOTAVE PËR KRYETAR KOMUNE 49
NUMËRIMI I VOTAVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE 50
NUMËRIMI I VOTAVE TË KANDIDATËVE 52

VII. FORMULARËT E REZULTATEVE — 54

SI TË PLOTËSOHET FORMULARI I PËRPUTHJES SË TË DHËNAVE DHE REZULTATEVE FPR 54

VIII. PAKETIMI — 56

PAKETIMI NË VENDVOTIM 56
PAKETIMI - NË VENDVOTIM TË DYFISHT 57

IX. TRANSPORTIMI I MATERIALEVE NË DEPO KOMUNALE ——— 58

TRANSPORTI NË DEPO TË KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR 58
SHTOJCA 1: FORMULAR I PËRPUTHJEVE TË REZULTATEVE 59
SHTOJCA 2: FORMULARI I PËRPUTHJES SË REZULTATEVE PËR KUVEND KOMUNAL 60
SHTOJCA 3: FORMULAR I REZULTATEVE PËR KRYETAR KOMUNE 61
SHTOJCA 4: FORMULAR I REZULTATEVE TË KANDIDATËVE 62
SHTOJCA 5: FLETË LLOGARITËSE PËR VOTA TË KANDIDATËVE (FLLK) 63
SHTOJCA 6: FORMULAR I KKZ PRANIM DORËZIM 64
SHTOJCA 7: DIAGRAMI I PAKETIMIT 65
SHTOJCA 8: DOKUMENTET E PRANUESHME TË IDENTIFIKIMIT 66
SHTOJCA 9: SHEMBUJT E FLETËVOTIMEVE TË VLEFSHME 68
SHTOJCA 10: SHEMBUJT E FLETËVOTIMEVE TË PAVLEFSHME 69
SHTOJCA 11: SHEMBUJT E FLETËVOTIMEVE TË VLEFSHME PËR KUVEND KOMUNAL 70
SHTOJCA 12: SHEMBUJT E FLETËVOTIMEVE TË PAVLEFSHME PËR KUVEND KOMUNAL 71
SHTOJCA 13: FORMULARI I ANKESËS I PZAP së 72

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E SISTEMIT ZGJEDHOR

SISTEMI DHE ZGJEDHJET NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave

Sipas ligjit për zgjedhje lokale dhe Kryetar të komunave secila komunë në Kosovë konsiderohet zonë e vetme zgjedhore për një anëtar. Rjedhimisht, eksistojnë tridhjetë e tetë (38) komuna ku secili Kryetar i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga votuesit të cilët janë të regjistruar për të votuar në komunën ku mbahen zgjedhjet.

Sistemi i votimit është i drejtëpërdrejt ngase votuesit përmes votimit të fshehtë votojnë për një (1) kandidat të subjektit politik të certifikuar që figuron në fletëvotim për atë komunë.
Kandidati zgjidhet Kryetar i Komunës nëse ai ose ajo fiton më shumë se pesëdhjetë përqind (50 %+1 votë), plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në atë komunë.
Nese askush nga kandidatët në garë nuk arrin të fitojë (50%+1 votë) në raundin e parë, KQZ organizon raundin e dytë në mes të dy kandidatëve që fituan më së shumti vota në raundin e parë.
Kandidati i cili fiton shumicen e votave në raundin e dytë zgjidhet Kryetar i Komunës.
Mandati i Kryatarit të Komunës është katervjeçar.

Sistemi - drejtëpërdrejtë (Dy raundësh)

Zona zgjedhore - 38 zona zgjedhore

Raundi i parë - Kandidati zgjidhet Kryetar i Komunës nëse ai ose ajo fiton më shumë se pesëdhjetë përqind (50 %+1 votë), plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në atë komunë.

Raundi i dytë - nëse askush nga kandidatët nuk fiton në raundin e parë, KQZ organizon raundin e dytë në mes të dy kandidatëve që fituan më së shumti vota në raundin e pare. Kandidati që fiton më shumë vota në këtë raund shpallet Kryetar i Komunes
Mandati - Katërvjeçar

Zgjedhjet për Kuvendet e Komunave

Sipas ligjit për zgjedhje lokale secila komunë në Kosovë konsiderohet zonë e vetme zgjedhore. Marrë parasysh këtë eksistojnë tridhjetë e tetë (38) zona zgjedhore. Secili kuvend i komunave zgjedhet përmes votave të votuesve që janë të regjistruar në komunën ku mbahen zgjedhjet për kuvend të komunës.
Numri i anëtarëve në kuvendet e komunave ndryshon, varësisht nga numri i banorve në komunë. Marrë parasysh këtë, kuvendet e komunave mund të kenë prej pesëmbëdhjetë (15) deri në pesëdhjetë e një (51) anëtarë.
Sistemi i votimit është i "Listës së hapur" ngase votuesit përmes votimit të fshehtë votojnë për një (1) subjekt politik të certifikuar, sidhe për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve nga po i njejti subjekt politik. Duhet theksuar se vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë, andaj KQZ siguron që bartësi i listës të mos figurojë në fletëvotim.

Kuota gjinore prej 30% - siguron që së paku 30% e kandidatëve të secilit subject politik të jenë nga secila gjini dhe ky është kriter obligues, që aplikohet edhe në ndarjen e ulësve për deputetë në Kuvende të komunave.

II TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË PROCES ZGJEDHOR

Në këtë kapitull do të mësojmë për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshem që marrin pjesë në një proces zgjedhor në Republiken e Kosovës. Akterët i ndajmë në të dy grupe, të brendshëm dhe të jashtëm. Akterët e brendshëm përbëjnë strukturen organizative, apo trupin menaxhues të zgjedhjeve ku hynë: KQZ, KKZ, Menaxherët e Qendrave dhe KVV; ndërsa akterët e jashtëm përfaqësojnë institucione të ndryshme si: Subjektet politike/Vëzhguesit, Mediat, Policia.
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershem, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës, dhe është një organ i përhershëm i pavarur përgjegjës për organizimin, administrimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë.
Roli i KQZ-së është të rregullojë procesin elektoral përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore dhe, mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standardet ndërkombëtare.

KQZ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: nga Kryesuesi dhe dhjetë (10) anëtarë të tjerë. Kryesuesi, emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe zgjidhet mes gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Mandati i Kryetarit të KQZ-së është (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës. Prerogativat e ushtrimit të detyrës së anëtarit të KQZ-së, caktohen në bazë të ligjit dhe, rregullat për ushtrimin e mandatit. Dhjetë (10) anëtarët e tjerë të KQZ-së, janë emëruar si rezultat i nominimeve të gjashtë (6) grupeve parlamentare më të mëdha të Kuvendit të Kosovës dhe, katër (4) anëtarë që përfaqësojnë komunitetet e vogla në Kosovë.

KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës.

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetë e tetë (38) komunat e Republikës së Kosovës për të ndihmuar organizimin e zgjedhjeve. KKZ-të janë përgjegjëse t'i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës së tyre gjegjëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. KKZ-të përbëhen nga shtatë (7) anëtarë dhe emërohen brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Mandati i KKZ përfundon pesëmbëdhjetë ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, ose sipas dispozitave tjera të përcaktuara në nenin 9 të Rregulles 18.

Përgjegjësitë e KKZ:

- **Plani operacional-** zbaton gjitha aktivitetet e parapara në plan
- **Fushata zgjedhore-** zbaton procedurat e parapara për fushatën zgjedhore dhe cakton një anëtar të KKZ-së si person kontaktues me policinë.
- **Lista e Menaxherve të QV- KKZ** përpilojnë listën e Menaxherëve të Qendrave të Votimit, dhe e përcjell në Komision
- **Propozon-** pozitat e anëtarëve në KVV, dhe personelit të qendrave të votimit të cilë angazhohen në ditën e zgjedhjeve

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershem, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

PZAP-i pranon ankesa në katër faza:

- Ankesa ndaj vendimeve të KQZ
- Ankesa gjatë periudhës parazgjedhore
- Ankesa për shkelje në ditën e zgjedhjeve
- Ankesat gjatë periudhës paszgjedhore

Afatet: Gjatë fushatës zgjedhore ankesa duhet të parashtrohet deri në 24 orë pas shkeljes, ndërsa shkeljet që ndodhin në ditën e zgjedhjeve duhet të dorëzohen në PZAP 24 orë pas mbylljes së vendvotimeve.

Kryesuesi i KVV-së është i obliguar të nformojë palët e interesuara për të drejtën e tij/saj për të parashtruar ankesë në Panelin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) duke i siguruar atij/asaj formularin e ankesës të PZAP-it që ndodhet në kompletin e pajisjeve të VV.

Votuesi duhet të informohet se formulari dorëzohet personalisht, me faks, ose me postë në zyrën e PZAP-it në rrugen "Migjeni" në Prishtinë

Mandati PZAP

- Organ i pavarur
- Menaxhon të gjitha ankesat dhe shkeljet në lidhje me zgjedhjet

Formular i Ankesës– dorëzohet sipas afateve ligjore në PZAP
- 24h-shkeljet në Ditën e Zgjedhjeve
- 24h-për shkeljet gjatë fushates

Sistemi i Menaxhimit të Rasteve - Përcjellja e statusit të rastit përmes Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (http://pzap.rks-gov.net)

Kontakti - Rruga Migjeni Nr. 21, Prishtinë. (http://pzap.rks-gov.net) Tel:
Me rëndësi: Çdo ankesë që ndërlidhet me procesin e votimit dhe numërimit duhet të dorëzohet në PZAP brenda 24 orëve, nga momenti i shkeljes së supozuar.

Vendimi - PZAP ka 72 orë për të marrë vendimin

ANKESAT NË PROCES ZGJEDHOR

Kush ka të drejtë të parashtrojë ankesë?

Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjekteve politike, komisionerët e vendvotimeve dhe vëzhguesit vendor kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë.

Kur janë afatet për dorëzimin e ankeses në PZAP?

Ankesat lidhur me shkeljet zgjedhore duhen të dorëzohen brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti kur shkelja e supozuar ka ndodhur.

Ankesat dorëzohen në PZAP nëse vërehen disa nga parregullësitë si në vijim, por jo vetëm këto: kërcënim i votuesit, vjedhje e votes, manipulim i rezultateve, votim më shumë se një herë nga një person apo parregullësi tjera gjatë fushates apo edhe në Qendër të Numërimit të Rezultateve.

Formularin e ankeses e gjeni në çdo vendvotim, apo edhe mund ta shkarkoni nga faqja zyrtare e PZAP http://pzap.rks-gov.net/ (Shtojca nr.13 e bashkëngjitur në Doracak)

Çfarë duhet të përmbajë një ankesë?

Ankesa që dorëzohet në PZAP duhet të përmbajë: a) emrin, adresën dhe kontaktet e personit i cili është ankuar; b) përshkrimin e detajuar të shkeljes së supozuar, përfshirë edhe datën, kohën, vendin e ngjarjes; c) detajet lidhur me ndonjë dëshmi, ndonjë kopje të ndonjë dokumenti relevant, fotografi, video/audio inqizim, apo lloje të tjera të dëshmive që mbështesin ankesën.

Ankesat/Shënimet në Librin e Votimit

Çdo vendvotim është i pajisur me nga një Libër të Votimit, ku shënohen ngjarjet e rëndësishme në lidhje me procesin e votimit në diten e zgjedhjeve. Këshillat e vendvotimit dhe vëzhguesit e akreditуar mund të shkruajnë direkt në Libër të Votimit ngjarje të rëndësishme rreth procesit të votimit apo të numërimit . Nëse një anëtar i këshillit të vendvotimit kundërshton rezultatet e regjistruara në formular të rezultateve mund të shënojnë vërejtjen e tyre në libër të votimit.

Votuesve nuk iu lejohet që të bëjnë shënime në Librin e Votimit, por në qoftë se ata kanë ndonjë ankesë lidhur me procedurat brenda vendvotimit, ata mund të kërkojnë nga kryesuesi që të shënoj ankesën në librin e votimit dhe pastaj të dorëzojnë ankesë zyrtare në PZAP.

PZAP mund t'i referohet librit të votimit gjatë procesit të hetimit. Informatat e shënuara në librin e votimit mund të rezultojnë në gjykim më efektiv të ankeses.

Shkeljet dhe krimet në zgjedhje janë të dënueshme

Sipas Kodit Penal, kapitulli 18, disa shkelje gjatë proçesit zgjedhor paraqesin akte kriminale dhe ato përcjellën direkt në Prokurorinë e Shtetit për hetime të mëtutjeshme. Disa nga këto shkelje janë: a) parandalimi i ushtrimit të së drejtes për të votuar, b) falsifikimi i rezultateve, c) keqpërdorimi i detyres zyrtare gjatë zgjedhjeve, ç) keqpërdorimi i së drejtes së votimit, d) cenimi i fshehtësisë së votimit dh) Cenim i përcaktimit të lirë të votuesit (Votimi familjar).

Kushdo që kryen ndonjëren nga këto vepra mund të denohet nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite burgim.

VËZHGUESIT DHE MEDIAT

Vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve luajnë rol të rëndësishëm në integritetin e zgjedhjeve duke e mbrojtur procesin kundër parregullsive e mashtrimeve dhe sigurojnë që rezultatet e zgjedhjeve të jenë të pranueshme për qytetarët e Kosovës. Të drejtat e vëzhguesve përforcojnë transparencën në zgjedhje, duke mundësuar qasje në vëzhgimin e proceseve zgjedhore.

Vëzhguesi i akredituar

- Mban dhe tregon kartelen e akredititimit të lëshuar nga KQZ gjatë qëndrimit në QV/VV
- Respekton dhe u përmbahet rregullave strikte të kodit etik në çdo kohë duke mos ndërhyrë në process zgjedhor dhe duke mos cenuar fshehtësinë e votës.
- Vëzhgon nga afër procesin e votimit dhe të numërimit
- I drejtohet vetem Kryesuesit të KVV-së për të gjitha preokupimet/verrejtjet apo sqarimet
- Anëtarët e KVV/Vëzhguesit e akredituar lejohen të shkruajnë në Libër të Votimit
- Jo më shumë se dy vëzhgues nga subjekti/organizata i/e njejtë i/e akredituar mund të jenë prezent në të njejtën kohë brenda në vendvotim

Mediat e akredituara

- Mbajnë dhe tregojnë kartelen e akredititimit të lëshuar nga KQZ gjatë qëndrimit në QV/VV
- Respektojnë dhe u përmbahen rregullave strikte të kodit etik në çdo kohë duke mos ndërhyrë në process zgjedhor dhe duke mos cenuar fshehtësinë e votës.
- vëzhgojnë procesin e votimit (me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi), përderisa nuk e pengojnë procesin e zgjedhjeve ose përderisa nuk e kufizojnë shfrytëzimin e ndonjë materiali të vendvotimit;
- filmojnë brenda qendrës së votimit/vendvotimit përderisa nuk incizojnë asnjë informatë personale të ndonjë votuesi ose përderisa nuk e shkelin fshehtësinë e votuesve
- filmojnë lëvizjen e votuesit nëpër qendër të votimit/vendvotim, me lejen e votuesit. (faqe 19)
- zhvillojnë intervista me votuesit (pas votimit të tyre) jashtë rrezes prej 25 metrash që e rrethon qendrën e votimit dhe me lejen e votuesit.

Kryesuesi i KVV mund të:

- Zvogëlojë numrin e vëzhguesve nëse vlerëson se numri i vëzhguesve të akredituar dhe mediat po e pengojnë procesin e votimit brenda vendvotimit, duke lejuar vetëm nga një vëzhgues nga secili subject politik të qendroj në VV në të njejten kohë.
- Komunikoj dhe shërben si urë ndërlidhësë në mes vëzhguesve dhe anëtarve të KVV për çfarëdo çështje që ata mund të shtrojnë.

Vëzhguesi nuk mund të:

- të ndërhyjë dhe pengojë mbarvajtjen e procesit zgjedhor
- të vëzhgojë kabinen e votimit përderisa votuesi është brenda duke votuar
- të japë urdhëra e as të debatoj me anëtarët e KVV-së lidhur me ndonjë procedurë në VV
- të ulen në të njejtën tavolinë me anëtarët e KVV-së.
- të marrin në për duar fletvotimet ose ndonjë material të ndjeshëm që përdoret në VV
- t'indihmojnë ndonjë votuesi
- Pasi të ketë filluar procesi i numërimit, vëzhguesit mund të largohen nga vendvotimi, por nuk

mund të kthehen dhe të hyjnë më aty pas fillimit të numërimit;
- Të flas drejtpërdrejt me anëtaret e KVV

Mediat nuk mund të:
- Filmojnë LPV-në/LVK dhe votuesin brenda kabines gjatë shënimit të fletëvotimit;
- Të intervistojnë brenda VV

TË DREJTAT E POLICISË

Policia e Kosoves janë të vendosur afër qendrave të votimit në Ditën e Zgjedhjeve për të ofruar siguri për tërë procesin sipas detyrave dhe përgjegjësive ligjore që ka Policia lidhur me Zgjedhjet

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE POLITKE

Kosova është republikë parlamentare që ka sistem shumëpartiak, që mundëson subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre të garojnë në zgjedhje për të fituar pozita udhëheqëse.
Për të garuar në zgjedhje subjektet duhet të certifikohen nga KQZ/ZRPP

Subjektet politike janë

1. Partitë Politike
2. Koalicionet
3. Iniciativa qytetare
4. Kandidatët e pavarur

për certifikim kërkohen

100 nënshkrime kur garojnë në një komunë
1000 nënshkrime nëse garojnë në 10 komuna ose më shumë

PERSONELI I QENDRAVE TE VOTIMIT

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Qendra e Votimit (QV) është ndërtesë në të cilën janë të vendosura një ose më shumë vendvotime (VV). Qendra e Votimit përfshin hapësirë publike brenda rrezes 25 metra nga dera e hyrjes në ndërtesë. Në shumicën e rasteve, ndërtesat që përdoren si Qendra të Votimit janë shkollat ose objektet e bashkësisë.

Vendvotimi (VV) është dhoma, salla ose objekti i ngjashëm i caktuar në QV ku do të zhvillohet votimi. Zakonisht vendvotimet janë klasë të shkollave. Në çdo vendvotim do të caktohen përafërsisht 750 votues.
Në çdo QV, vendvotimi me numër rendor të fundit është vendvotim i dyfishtë, ku mund te votohet në mënyrë të rregullt dhe me kusht. (p.sh. QV i ka total 4 vendvotime, vendvotimi # 4 është VV i dyfishtë)

Struktura e personelit të qendres së votimit:
- Menaxheri i Qendres
- Asistentët e Qendres së votimit
- Personeli i tavolines ndihëmse
-Personeli për futjen e të dhënave dhe rezultateve preliminare

Përgjegjësitë dhe Detyrat

Menaxheri QV-së

Një ditë përpara dhe në Diten e Zgjedhjeve, Menaxheri i Q.V. është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në Qendrën e Votimit dhe jashtë ndërtesës, brenda rrezes 25 metra nga dera e hyrjes në hapësirën publike të ndërteses.

Menaxheri i QV është përgjegjës për këto detyra:
- Pranimin e materialit të zgjedhjeve për Q.V. dhe materialit josensitiv për VV.
- Vendosjen e materialeve të zgjedhjeve në dhomë/vend të sigurt brenda Q.V.
- Së bashku me stafin vendos shenjat dhe udhëzimet informuese dhe drejtuese për votuesit para Dites së Zgjedhjeve.
- Sigurohet që objekti-Qendra e Votimit të jetë e përgaditur dhe e gatëshme për tu hapur para orës 06:00.
- Ofron qasje për të gjithë kategoritë e votuesve (vendos/improvizon pjerrina, nëse mungojnë)
- Komunikon me KKZ për çështjet organizative dhe operacionale te QV

- Pranon materialin jo-sensitiv (jo të ndjeshëm)
- Shpërndan materialet e zgjedhjeve Kryesuesve
- Ndërlidhet me KKZ për transportin e materialeve të zgjedhjeve në QV dhe anasjelltas.
- Raporton për mbylljen e Q.V.
  - Informon, koordinon me KKZ-në, mungesat a KVV ose të materialeve
  - Informon KKZ-në për çdo zhvillim me rëndësi brenda QV-së
  - Kujdeset deri sa të zgjassë procesi i numërimit që brenda QV-së të hynë vetëm personat e autorizuar (personeli i SKQZ/KKZ-së,Trajneret e KVV-së,policia në rast se thirret për intervenim).
  - Delegon detyrat dhe mbykqyr punen e personelit teknik të QV-së
  - Se bashku me asistentet e QV-es kujdeset per orientimin e votuesve
  - Raporton në KKZ:

Në ora 07:00 raporton hapjen e VV
Në ora 11:00; 15:00 dhe 19:00 raporton daljen e votuesve në zgjedhje (numrin e votuesve për VV) Në ora 19:00 raporton mbylljen e QV dhe VV.
- Vendos Tavolinen Ndihmëse në vend të përshtatshëm me qasje të barabartë për të gjithë votuesit.
- Akomodon personelin e Rezultateve Preliminare që janë përgjegjës për futjen e rezultateve preliminare.

Cakton një person ndihmës nga radhët e stafit të QV-së i cili do të bëjë grumbullimin e të dhënave nga secili vendvotim, mbi numrin/përqindjen e daljes së votuesve në votime, në tri intervale kohore: 11:00, 15:00 dhe 19:00.

NUK është përgjegjës për:
- Zgjidhjen apo të përgjigjet në pyetjet lidhur me procedurat e votimit në VV. Pyetjet e këtij karakteri adresohen tek trajneret në komuna, apo tek trajneret që kujdestarojnë në Dhomen Operative në Diten e Zgjedhjeve.

Asistentët e Qendrave të Votimit

Asistentët e Qendrës të Votimit janë përgjegjës për të përgatitur Q.V. me të gjitha shenjat drejtuese dhe informuese dhe drejtimin/orientimin e votuesve brenda dhe jashtë Qendrës së Votimit. Numri i Asistenve do të jetë në proporcion me numrin e VV.

Asistentët e QV-së janë përgjegjës për këto detyra:

- Përgatisin QV një ditë para Dites së Zgjedhjeve
- Në Diten e Zgjedhjeve vijnë në QV në ora 06:00
- Vendosin shenjen/Numrin e QV në vend ku duket dhe shihet nga votuesit nga jashtë.
- Largon dhe hek çfardo materiali që i përket fushates zgjedhore e që ndodhet brenda dhe jashtë QV-së në një rreze prej 100 metra për rreth QV-së.
- Parandalojnë grumbullimin e turmës në QV duke ndihmuar lëvizjen brenda dhe jashtë ndërtesës:
- Raportojnë incidentet tek menaxheri i QV-së për të siguruar process të rregullt
- Sipas nevojës, ndihmojnë votuesit që kërkojnë ndihmë siç mund të jenë: votuesit e moshuar gratë shtatzëna, votuesit me nevoja te veçanta, zyrtarëve të uniformuar të PK-së në detyrë, sidhe personelit zgjedhor (KVV) i jep përparësisi të kalojnë në krye të radhës.
- Në ora 19:00, lejojnë votuesit që janë duke pritur jashtë të hynë brenda QV dhe të votojnë.
- Mbyllin deren kryesore të QV. Gjatë mbylljes, asistentët monitorojnë për se afërmi QV-në. Nëse është formuar radha jashtë, njeri nga asistentët e QV-së duhet te vendoset prapa personit të fundit në radhë, për te siguruar që asnjë person tjetër të mos bashkëngjitet, pasi Menaxheri ka mbyllur zyrtarisht QV.
- Udhëzojnë votuesit tek daljet nga QV pasi të kenë votuar.
- Pastrojnë dhe rregullojnë objektet një ditë para votimit si dhe pas përfundimit të procesit të numërimit

Personeli i Tavolinës Ndihmëse

Çdo Qendër e Votimit, do të ketë te paktën një Tavolinë Ndihmëse, ku do të sherbejnë dy zyrtarë, të cilët do të jenë të pajisur me Listën e Gjerë Komunale të Votuesve (në CD apo të shtypur) detyra e cilëve do të jetë informimi i votuesve se ku dhe në cilin vendvotim janë të caktuar të votojnë.

Personeli i Tavolines Ndihmëse është përgjegjës për këto detyra:

- Informon votuesit se në cilen Qender Votimi dhe Vendvotim janë të caktuar të votojnë, duke udhëzuar vendndodhjen e QV-së dhe emrin e lokacionit (objektit).
- Mban shabllonat e "Brail-it" për t'iu shërbyer votuesve të verbër.

Personeli për Rezultatet Preliminare (K-VOTE)

Personeli/Zyrtari për rezultatet preliminare është përgjegjës për a) raportimet e daljes së votuesve në zgjedhje dhe b) për futjen e rezultateve preliminare pasi fletëvotimet të jenë numëruar në VV.

Menaxheri i QV do të cakton një ndihmës që t'i dergojë të dhënat tek zyrtari për rezultatet preliminare.

Zyrtari bashkë me ndihmësin është përgjegjës për këto detyra:
- Mbledhjen e të dhënave (numrin e votuesve) mbi daljen e votuesve në zgjedhje nga Kryesuesi i VV në intervalet kohore 11:00; 15:00 dhe 19:00.
- Pas përfundimit të numërimit, merr nga Kryesuesi kopjen e pestë (të verdhë) të FPR dhe e dorëzon tek Zyrtari për futjen e të dhënave të rezultateve preliminare.

Pasi të numërohen votat për Kryetar Komune dhe regjistrohen në FPR, Kryesuesi i vendvotimit është i obliguar të ju jap kopjen e rezultateve zyrtarit për futjen e të dhënave preliminare (K-vote)

Dhe pasi të numërohen votat për Kuvendin Komunal dhe regjistrohen në FPR, Kryesuesi i vendvotimit është i obliguar të ju jap kopjen e rezultateve zyrtarit për futjen e të dhënave preliminare (K-vote)

KËSHILLI I VENDVOTIMIT (KVV)

Këshilli i Vendvotimit (ne tekstin e mëtejmë "KVV") është trup zgjedhor, që caktohet në çdo vendvotim dhe është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor në vendvotim.

Përbërja e Këshillit të Vendvotimit (KVV) reflekton strukturën e anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ). Vendvotimi mund të hapet me tre (3) anëtarë, por për të funksionuar procesi zgjedhor brenda vendvotimit, ekipi i KVV-së duhet të ketë 5 anëtarë. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mundet, në raste të veçanta, ta shtojë numrin e anëtarëve në Këshillin e Vendvotimit dhe për këtë menjëherë ta njoftojë Komisionin.
KVV- të udhëhiqen nga Kryesuesi i KVV-së

POZITAT DHE FUNKSIONET E KVV

- Kryesuesi i KVV-së,
- Kontrolluesi i rreshtit (K. Rr),
- Zyrtari i identifikimit (Zyrtari i ID),
- Dhënësi i fletëvotimit (Dh. F),
- Mbikëqyrësi i kutisë së votimit (MKV),

- Ndihmësi i zyrtarit te identifikimit dhe
- Ndihmësi i dhënësit të fletëvotimit.

PARIMET THELBËSORE TË KVV

- Si anëtar i Këshillit të Vendvotimit (KVV), duhet të demonstroni nivel të lartë përkushtimit dhe të vini të përgatitur për kryerjen e detyrave me kompetencë dhe profesionalizëm duke ofruar shërbim cilësor dhe të sjellshëm për të gjithë votuesit dhe akterët tjerë në mënyrë të barabartë gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve.
- Vijoni trajnimin, përgatiteni vendvotimin paraprakisht, sidhe zbatoni gjitha detyrat e caktuara nga Kryesuesi në Diten e Zgjedhjeve.
- Tregoni kujdes të shtuar për kategoritë e votuesve si: të moshuarit, gratë shtatëzëna, për përsonat me aftësi të kufizuara, sidhe për votuesit me asistencë.

KRYESUESI I KVV

Kryesuesi i KVV është përgjegjësi kryesor që ushtron detyren në mënyrë profesionale dhe të paanshme në menaxhimin dhe funksionimin e përgjithshëm të vendvotimit duke kryer detyrat/punen me saktësi dhe në përputhje me rregullat dhe doracakun e KQZ-së.

Kryesuesi është përgjegjës për:

- Zbatimin e të gjitha procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit me përpikëri.
- Cakton detyrat e të gjithë anëtarëve të KVV-së
- I referohet doracakut të trajnimit kur has në paqartësi procedurale lidhur me Diten e Zgjedhjeve
- Mbiqkyrë të gjitha operacionet brenda Vendvotimit dhe këshillon KVV dhe përmirëson procesin.
- Siguron zbatimin e të gjitha rregullave të zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe parandalon parregullësitë.
- Shënon parregullësitë në Libër të Votimit dhe njofton KKZ
- Cakton zëvendësues në rast kur nuk mund të qëndroj në VV.
- Mban qetësinë dhe rregull në Vendvotim (VV).
- Mban kontakte me mediat, vëzhguesit e akreditуar dhe personelin e sigurisë që vijnë në VV (përgjegjësi ekskluzive e Kryesuesit/es)
- Kontakton Trajnerët e SKQZ për pyetje dhe sqarime lidhur me procedurat e votimit & numërimit
- Kontakton/komunikon me KKZ-në për çështje operative
- Raporton në Ditën e Zgjedhjeve për numrin e daljes së votuesve në zgjedhje në ora 11:00, 15:00 dhe 19:00.
- Kryesuesi i Vendvotimit është i obliguar që 5 (pesë) minuta para kohës së raportimit në ora 11:00, 15:00 dhe 19:00 ti ofroj të dhenat-statistikat e perqindjes së daljes së votueseve në atë vendvotim, ndersa menjëherë pas perfundimit të numërimit të fletëvotimeve për Kryetar Komune (FPR) dhe menjëherë pas numërimit të fletëvotimeve për Kuvendin komunal (FPR) ti dorezoje kopjen e 5 (pestë) të verdhe të FPR-së personelit për rezultate preliminare në QV (K-VOTE).
- Plotëson formularin me të dhënat e përqindjes së daljes në votim dhe ia jep personelit për rezultate preliminare i cili nenshkruhet nga të dy palet
- Kryesuesi i Vendvotimit raporton te Menaxheri i Qendres së Votimit për: a) Hapjen e VV në ora 07:00: b) Daljen e votuesve në zgjedhje duke raportuar numrin total të votuesve në këto intervale: 11:00 raporton numrin votuesve, 15:00 numrin votuesve, 19:00 numrin votuesve dhe mbyllja e VV

Për vendvotimet të cilat akoma nuk janë mbyllur për shkak të fluksit të votuesve, kryesuesi pret perfundimin e procesit dhe me pastaj permes Menagjerit te QV, do te raportoj ne KKZ.

Para Ditës së Zgjedhjeve

- Vijon trajnimin
- Studijon dhe mëson procedurat e votimit dhe numërimit
- Njoftohet me KKZ
- Pranon materialin jo të ndjeshëm
- Rregullon Vendvotimin duke vendosur shenjat dhe tavolinat

Para hapjes së VV

- Pranon materialin e ndjeshëm
- Cakton detyrat e KVV
- Kontrollon materialet
- Para hapjes zyrtare shfaq kutinë e votimit tek të pranishmit
- Vendos lidhëset e sigurisë në kuti
- Regjistron numrat në formular

Hapja e Vendvotimit - Votimi

- Në ora 07:00 shpall VV zyrtarisht të hapur per votim
- Shënon në Librin e votimit: a) kohën e hapjes dhe emrat e anëtarëve të KVV-së. b) emrat dhe numrat e DI-ve të akreditimit të vëzhguesve të pranishëm.
- Mbikëqyrë zhvillimin e procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim në përputhje me Ligjin//Rregullat e zgjedhjeve
- Siguron që të gjithë formularët e nevojshëm të jenë në vendvotim dhe të plotësohen në mënyrë të saktë.
- Raporton të dhënat për K-VOTE sipas orarit (shih më lart tek detyrat e Kryesuesit të KVV-së)
- Mban kontakte me vëzhgues dhe media



Mbyllja e Vendvotimit dhe Numërimi

- Mbyll deren e VV (19:00) ne bashkpunim me Menaxherin e QV
- Mbyll vrimen e kutisë me lidhëse të sigurisë
- Cakton një anëtar të KVV të dera
- Rregullon hapsiren/tavolinat për numërim
- Mbikëqyrë procesin e numërimit
- Plotëson formularet të FPR-së/FRK .
- Mbikqyrë paketimin e materialeve
- Ofron kopjen e rezultateve personelit të K-Votes
- Transporton materialin e KVV në depon Komunale

KONTROLLUESI I RRESHTIT

Është përgjegjës për kontrollimin e gishtrinjëve të votuesve me llampen ultra vjollcë para se të hynë në vendvotim. Detyrat e Kontrolluesit të rreshtit janë:

Votuesi në Vendvotimin e duhur

1. Këshillon votuesit të kontrollojnë a janë duke pritur në vv të duhur.

2. Udhëzon votuesit të bëjnë gati dokumentet identifikuese.

3. Tregon kujdes të shtuar me të moshuarit, dhe personat me aftësi të kufizuar .

Procesimi i Votuesit

Detyra kryesore është:
1. kontrollon gishtat e votuesve me llampë ultra vjollcë

2. I drejton te Zyrtari i Identifikimit

Menaxhimi turmës

1. Menaxhon numrin e personave/votuesve brenda vv në të njejten kohë.

2. Mbyll derën e vendvotimit pasi të udhëzohet nga Kryesuesi.

Në Diten e Zgjedhjeve Kontrolluesi i Rreshtit do të:

Votuesi nuk lejohet të hyjë në vendvotim në këto raste:

1. **Kur zbulohet ngjyra në gishtërinjë**
2. **Kur votuesi refuzon kontrollimin e gishtave**
3. **Kur ndodhet në vendvotimin e gabuar drejtohet tek tavolina ndihmëse në QV**

ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT

Është përgjegjës për identifikimin e votuesit, gjetjen e tij/saj në LPV dhe ta udhëzon të nënshkruhet në LPV.

1. I kërkon votuesit dokument të pranueshëm të identifikimit

2. Verifikon identitetin e votuesit duke krahasuar të dhënat si # personal dhe fotografinë në dokument identifikues

3. Gjen votuesin në Listë Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe e udhëzon ku të nënshkruhet.
- E drejton Votuesin te Dhënësi i Fletëvotimeve

Materialet e nevojshme
për të kryer detyren janë:

- Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV)
- Doracaku i Procedurave
- Kimik
- Pusulla të letrës

Për të votuar:

Votuesi duhet të ketë së paku **18 vjet,** të **dëshmojë identitetin** e vet përmes **Dokumentit të identifikimit te pranueshem**, sidhe ta ketë emrin në Listen Përfundimtare të Votueseve në vendvotim apo në Listen e Votueseve të Komunes përkatese.

Votuesit i mohohet e drejta e votimit në rast se nuk prezanton ndonjërin nga dokumentet zyrtare të pranueshme.

Dokumentet e pranueshme të identifikimit janë:

- Letërnjoftimi i vlefshëm;
- Pasaporta valide;
- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
- Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës;
- Kartela e vlefshme e PZHBV-ve; ose
- Kartela e vlefshme e refugjatit.



Votimi përmes ndihmësit

•Nëse votuesi kërkon ndihmë për shkak se nuk din shkrim dhe lexim dhe nuk është në gjendje të shënojë fletëvotimin në kabinë, udhëzohet ta gjejë një person me DI jashtë vendvotimit për ta ndihmuar.

•Kryesuesi i KVV së shenon të dhënat personale të asistuesit dhe të votuesit te asistuar ne Librin e Votimit dhe kohën.

•Kryesuesi bashkë me anëtarët e KVV janë të obliguar të mos lejojnë çfardo keqpërdorimi të drejtës së votës, ose tentim të votohet për dikë, apo të cënohet përcaktimi i lirë i votuesit (votimi familjar) sepse janë vepra penale dhe të denueshme me burgim.



Kryesuesi me anëtarët e KVV dhe vëzhguesit nuk kanë të drejtë të ndihmojnë votuesin.

Ndihmësi ka të drejtë të ndihmojë vetem një herë

Nuk lejohet nënshkrimi i LPV përmes"VENJES SË SHENJËS SË GISHTIT"

Procesi i Votimit të rregullt

Votuesi

Votuesi/ja hyn në vendvodim të duhur

Zyrtarë i Identifikimit



Udhëzohet të kthehet në VV me DI

Votuesi pa DI

HAPI 1

Zyrtarë i identifikimit i kerkon një **Dokument Identifikues (DI)** të pranueshëm

Votuesi me DI



E drejton te Tavolina Ndihmese ne QV

Jo

HAPI 2

A është votuesi në Liste përfundimtare të votuesve **(LPV)?**

Po





Nuk vazhdon; E udhëzon
të dalë jashtë VV

Nëse votuesi nuk
nënshkruan

HAPI 3

**I kërkon votuesit
të nënshkruhet
pranë emrit**

Votuesi
nënshkruan



HAPI 4

**Votuesi nënshkruhet
në LPV dhe vazhdon të
dhënësi i Fletëvotimeve**

Kush mund të votojë?

- Votuesi duhet të dëshmoj se: a) është 18 vjeç apo më i vjetër se 18 në Ditën e Zgjedhjeve. b) Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm në komunën ku është i regjistruar si qytetar/banor i përhershëm c) të dëshmojë identitetin e vet permes Dokumentit të identifikimit të pranueshëm. d) emri i tij/saj të jetë i përfshirë në Listen Përfundimtare të Votuesve në vendvotim apo në Listën Votuese të Komunës përkatëse.

Kush nuk lejohet të votojë?

- Votuesi/ja i/e cili/a nuk është së paku 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve.
- Votuesi/ja të cilit nuk i figuron emri në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) të atij vendvotimi apo ne Listen e Votueseve të Komunes përkatese dhe nuk ka Dokument Identifikimi të pranueshem.
- Votuesi/ja që refuzon të nënshkruhet në LPV: votuesit/es i refuzohet dhënia e fletëvotimit dhe rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi.
- Votuesi nuk voton kur Kontrrolluesi i Rreshtit zbulon ngjyren e padukshme në gisht të votuesit. Rasti shkruhet në libër të votimit nga Kryesuesi
- Votuesi refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme, votuesit i refuzohet dhënia e fletëvotimit- udhëzohet jashtë; në LPV te pjesa ku është nënshkruar bëhet me shejë dhe shlyhet nënshkrimi. Rasti shkruhet në liber të votimit.

Kur Votuesi voton me kusht?

Sipas Ligjit dhe Rregullave për zgjedhje, votuesi voton ME KUSHT në rastet kur:

- Emri dhe mbiemri nuk gjindet ne LPV; ose
- Pranë emrit dhe mbiemrit eksiston një shenjë/vulë e vënë nga KQZ;
- Votuesi voton nëse identiteti mund të verifikohet sipas kritereve të cekura në nenin 17 të Rregulles 18 të KQZ;
- Votuesit jashtë Kosoves votojnë me kusht;

Zyrtari i Identifikimit është përgjegjës për këto detyra:

1. I kërkon votuesit dokument të pranueshëm të identifikimit
2. Verifikon identitetin e votuesit duke krahasuar të dhënat QV, # personal dhe fotografinë në dokument identifikues
3. Shkruan të dhënat personale në Listë të Votuesve me Kusht (LVK) dhe e udhëzon ku të nënshkruhet.
4. Plotëson Zarfin e bardhë (ZVK) me të dhënat personale të votuesit
5. Udhëzon votuesin të nënshkruhet në Listen e Votuesve me Kusht (ZVK) dhe në Zarf të Votimit me Kusht (ZVK)
6. Ia dorëzon dokumentin e identifikimit dhe ZFK-në e kompletuar, Dhënësit të fletëvotimeve (DhF).
7. E drejton votuesin te Dhënësi i fletëvotimeve.

Materialet shtesë:

- Zarfat e bardhë (ZFK)
- Zarfi i fshehtësisë
- Lista e Votuesve me Kusht

Shenim: Të dhënat e votuesit shkruhen vetem me shkronja të shtypit.

DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE

I pranon Fletëvotimet në Diten e Zgjedhjeve nga Kryesuesi i VV dhe është përgjegjës për mbajtjen e fletëvotimeve në gjendje të rregullt dhe të sigurt në vendvotim. Poashtu është përgjegjës të kontrollojë, numërojë dhe të informojë kryesuesin e KVV-së nëse ka ndonjë fletëvotim të dëmtuar ose me gabime shtypi

Materiali i nevojshëm:

-Fletëvotimet dhe Broshurat e kandidatëve
-Spreji
-Vulja
-Palloma
-Doracaku i Trajnimit
-Zarfi i fletëvotimeve me kusht (ZFK) dhe zarfi i fshehtësisë.

PROCESIMI I VOTUESIT

Hapi 1: Spërkat gishtin e djathtë tregues të votuesit me ngjyrë të padukshme, me kujdes të shtuar që të mos spërkas fletvotimet.
Hapi 2: Shkëput vetëm një fletëvotim njëherësh nga amat e fletëvotimit (të gjitha amat e përdorura të fletëvotimeve duhet të ruhen, sepse numërohen në fund, kur mbyllet vendvotimi.
Hapi 3: Kthen fletëvotimin nga prapa dhe e vulos me vule zyrtare në pjesën e epërme të fletëvotimit.
Hapi 4: Sqaron dhe udhëzon votuesin për formatin e fletëvotimit dhe si votohet.
Udhëzimet për votuesin janë: Informon votuesin se si ta shënojë fletëvotimin dhe si ti shfrytëzojë broshurat e kandidatëve për zgjedhjet e kuvendeve të Komunave.

- **Për zgjedhjet për Kuvendet e Komunave: 1+1** (1 votë për subjektin politik dhe 1 votë për një kandidat të subjektit politik të njejtë)

Hapi 5: Jep fletëvotimin dhe e drejton votuesin tek kabina e lirë e votimit që të votojë në fshehtësi

Në raste të jashtëzakonshme

Nëse votuesi nuk e ka gishtin i djathtë tregues të dorës së djathtë spërkateni gishtin e madh, të mesëm të unazës osë gishtin e vogël. Nëse i mungojnë gishterinjët e dores së djathtë vazhdohet me të njejtën procedurë me dorën e majtë. Nëse votuesi nuk e ka asnje gisht atëhere hiqet dorë nga procesi i sperkatjes dhe votuesi udhezohet për te kabina e votimit që të voton.Rasti shenohet në librin e votimit nga Kryesuesi

Kur votuesi dëmton fletëvotimin: Dhënësi i Fletëvotimeve, pranon fletëvotimin e dëmtuar, e kthen nga prapa dhe shkruan "i dëmtuar". E vendos në zarfin e përcaktuar "fletëvotimet e dëmtuara". Ofron udhëzime për formatin e fletëvortimit dhe mënyren e votimit. Pastaj ia jep votuesit vetëm edhe një fletëvotim tjetër të vulosur.

Fletëvotimet

Rreptësisht ndalohet shkeputja e fletëvotimit të pa vulosur nga Dengu i fletëvotimit, pa prezencen e votuesit.

Rreptësisht ndalohet dalja e Fletevotimeve nga Vendvotimi dhe Qendra e votimit.



Votuesi

Votuesi/ja është nënshkruar në LPV dhe ndodhet pranë Dhënësit të Fletëvotimeve

Dhënësi i Fletëvotimeve

Vazhdon me gishtin pasues të dores

Nëse nuk e ka

HAPI 1

Zyrtari Dh.F. i kërkon votuesit gishtin tregues të dores së djathtë

Nuk vazhdon, udhëozhet të dalë jashtë VV

Votuesi refuzon

HAPI 2

Spërkat gishtin me sprej

Votuesi Pranon


HAPI 3
Vulos fletëvotimin nga prapa dhe ofron udhëzime sqaruese si votohet.
Votuesi pranon fletëvotimin
VULA
HAPI 4
Votuesi shkon te kabina votimit

Kur Votuesi voton me KUSHT

Kur votuesi shkon në kabinë votimi, Dh. F. ia dorëzon dokumentin e identifikimit bashkë me zarfin e fshehtësisë dhe ZFK-në e plotësuar Mbikëqyrësit të Kutisë së Votimit.

Në rastet kur votuesi që voton me kusht, gabisht vendos fletëvotimin në kuti të votave pa zarfet përkatëse, Kryesuesi është i obliguar të fut zarfin e fletëvotimit me kusht (ZFK) brenda në kuti të votave dhe rastin ta shkruan në libër të votimit.



ZFK
Zarfi i Fletëvotimeve me Kusht

MBIKQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT

Është përgjegjës për mbikqyrjen e kutisë së votimit dhe sigurohet që vetëm fletëvotimet e vulosura futen brenda.

PROCESI

Hapi 1: Kërkon të sheh vulën zyrtare prapa fletëvotimit para se të futet në kutinë e votimit.
Hapi 2: Siguron që secili votues t'i hedhë fletëvotimet në kutinë përkatëse të votimit.
Hapi 3: Siguron që votuesit të votojnë një nga një me radhë dhe që vetëm një votues të jetë prapa kabinës së votimit në të njëjtën kohë.
Hapi 4: I drejton votuesit për në DALJE nga vendvotimi pasi të kenë votuar.

Kohë pas kohe:
- Rregullisht i kontrollon kabinat e votimit për të siguruar që stilolapsi të jetë në dispozicion aty dhe që broshurat e kandidatëve për zgjedhjet e Kuvendeve të Komunave të jenë në gjendje të rregullt.
- Çfarëdo shkrimi i papërshtatshëm në kabinat e votimit do të mbulohet, ndërsa broshurat e manipuluara të kandidatëve do të zëvendësohen.

Kur votuesi voton me kusht
Përveç detyrave të zakonshme, Mbikqyrësi i kutisë është përgjegjës edhe për disa detyra shtesë:

PROCESI tek votuesit që votojnë me kusht:
Hapi 1: Merr nga dhënësi i fletëvotimeve dokumentin e identifikimit të votuesit, një zarf të fshehtësisë dhe ZFK-në.
Hapi 2: Kërkon të sheh vulen prapa fletëvotimeve (F. Kryetar dhe F.Kuvend Komunal)
Hapi 3: Ia jep votuesit zarfin e fshehtësisë dhe e udhëzon ta vendos fletëvotimin brenda dhe ta mbyll.
Hapi 4: Pastaj ia jep Zarfin e Fletëvotimeve me Kusht (ZFK) të kompletuar me të dhëna dhe i kërkon votuesit ti vendos zarfat e fshehtësisë brenda dhe ta mbyll.
Hapi 5: Udhëzon votuesin ta hedh ZVK e mbyllur te kutia e votimit me kusht.
Hapi 6: Kontrollon dhe krahason dokumentin e identifikimit të votuesit dhe pasi votuesi/ja vendos zarfin në kuti, ia jep dokumentin e identifikimit.

Raste të jashtëzanoshme
Nëse votuesi, fletëvotimin ose zarfin e tij/saj të fshehtësisë e vendosë drejtpërdrejt në kutinë e votimit pa ZFK, MKV-ja do ta informojë kryesuesin e KVV-së, i cili do ta shënojë rastin në Librin e Votimit. Pastaj, MKV-ja do të kërkojë nga votuesi që ZFK-në e zbrazët ta vendosë në kutinë e votimit të fletëvotimeve me kusht, pastaj ia kthen votuesit dokumentin e votimit dhe e drejton atë për në dalje të vendvotimit.

III PËRGATITJET PËR VOTIM

PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Në këtë kapitull janë përshkruar procedurat dhe detyrat e personelit zgjedhor lidhur me përgatitjet e nevojshme për rregullimin e duhur të Qendrave të votimit dhe vendvotimeve që do të përdoren gjatë organizimit të zgjedhjeve përkatëse.

Personeli Zgjedhor obligohet si në vijim:

ZYRTARI I LARTË KOMUNAL ZGJEDHOR

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve përmes ZLKZ siguron dhe mbikqyrë të gjitha përgatitjet zgjedhore në nivel të komunes duke siguruar se personeli zgjedhor i caktuar udhëzohet dhe pranon materialet zgjedhore sipas afateve të përcaktuara në plan operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Menaxheri i QV

1.Vijon trajnimin përgjegjësit dhe detyrat e menaxherit dhe stafit teknik.

2. Pranon pakon me materiale të QV-së nga Kryesuesi i Vendvotimit të dyfishtë.

3.Hap dhe rregullon qendrën e votimit një ditë para Dites së Zgjedhjeve duke vendos gjitha shenjat dhe udhëzimet për votues.

4.Në bashkëpunim me KKZ-në dhe Policinë, kujdeset për sigurinë e materialit jo të ndjeshëm zgjedhor.

5.Siguron qasjen për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, vendos pjerrina në hyrje dhe dalje

Kryesuesi i KVV

1. Vijon trajnimin për procedurat e votimit dhe numërimit.

2. Pranon pakon me materiale të VV-së nga KKZ

3.Hap dhe rregullon vendvotimin një ditë para Dites së Zgjedhjeve duke vendos gjitha shenjat dhe udhëzimet për votues.

Materialet e Zgjedhjeve dhe Shpërndarja e tyre

Para Dites së Zgjedhjeve Zyrtari i Lartë Komunal (ZLKZ) është i obliguar dhe përgjegjës për shpërndarjen e materialeve jo të ndjeshme personelit zgjedhor (Menaxherve dhe Kryesuesve të vendvotimeve). Kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente duke evidentuar çdo material që dorëzohet/pranohet në formular zyrtar për pranim/dorëzim. Çdo material që dorëzohet/pranohet duhet të kontrollohet/testohet paraprakisht bashkarisht në mes Kryesusit dhe KKZ. Çdo vërrejtje/mungesë apo mos-funksionim i materialit raportohet tek ZLKZ/KKZ.

Materialet e zgjedhjeve ndahen në dy grupe, të ndjeshme dhe jo të ndjeshme. Materialet shpërndahen sipas planit operacional dhe udhëzimeve të SKQZ.

MATERIALET PËR VENDVOTIM

Tabela në vijim ilustron llojet e materialeve që do të përdoren nga KVV në vendvotim. Kryesuesi është përgjegjës para pranimit të kontrollon/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në formular. (shih shtojcën numër 6 në fund të doracakut).



MATERIALET

Shpërndarja	Jo të ndjeshme	Të Ndjeshme
Para Zgjedhjeve (-1 ditë)	✓ Lista e gjërë Komunale ✓ Lidhëset e sigurisë ✓ Llamba ultravjollce (UV Llamba) ✓ Libri i votimit ✓ Formulari i përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve (FPR) ✓ Formulari i rezultateve të kandidatit (FRK) ✓ Fletët llogaritëse të kandidatit ✓ Ngjyra dhe mbushësit "jastyku i vules" ✓ Kabinat e votimit ✓ Kutitë e votimit ✓ Formular për ankesa në PZAP Nëse vendvotimi është i dyfishtë edhe këto: ✓ Zarfi Fletëvotimve me Kusht (ZFK) ✓ Zarfi i fshehtësisë	
Në Ditën e Zgjedhjeve		Kryesuesi pranon në mengjes: ✓ Fletëvotimet ✓ Lista përfundimtare e votuesve (LPV) ✓ Vula ✓ Broshurat e kandidatëve ✓ Ngjyra e padukshme (Spreji) Kryesuesi transporton në KKZ: Zarfi i KKZ ✓ LPV ✓ FPR dhe FRK ✓ Libri i Votimit ✓ Lidhëset e sigurisë Kutia votimit ✓ Thesi 2 dhe 4 ✓ Zarfi 1 dhe 3 ✓ FLK ✓ Vula

MATERIALET PËR QENDËR TË VOTIMIT

Tabela në vijim ilustron listat e materialeve që do të përdoren nga Menaxherët dhe personeli teknik i Qendrës së Votimit. Menaxheri i QV është përgjegjës para pranimit të kontrollon/teston të gjitha materialet dhe të nënshkruaj në formular.

MATERIALET

Shpërndarja	Jo të ndjeshme	Të Ndjeshme
Para Zgjedhjeve (-1 ditë)	✓ Lista e gjërë Komunale ✓ Shablion të "Brail" për votim të personave të verbër ✓ Shenja dhe poster informues ✓ Material administrative (lapsa, marker, letër dhe ngjitës) ✓ Formular për ankesa në PZAP	
Në Ditën e Zgjedhjeve	Bashkë me personelin teknik organizojnë dhe mbledhin tërë materialin zgjedhor jo të ndjeshëm dhe e përgatisin për ta transportuar në depo komunale të KKZ.	Tabletet e personelit për raportim të rezultateve preliminare.

RREGULLIMI I QENDRAVE TË VOTIMIT DHE VENDVOTIMEVE



Rregullimi i Vendvotimit

Kryesuesi bashkë të gjithë anëtarët e KVV-së janë përgjegjës për përgatitjen dhe rregullimin e Vendvotimit një ditë para Dites së Zgjedhjeve.

Si regullohet vendvotimi

-Shikon ilustrimin me foto në Doracak se si duhet të rregullohet vendvotimi dhe i organizon tavolinat sipas skices/fotos.

-Largon çfardo materiali të fushates zgjedhore

-Organizon tavolinat për të mundësuar qarkullim sa më efikas të votuesve gjatë Ditës së Zgjedhjeve

Ulëset duhet te rregullohen ne ate menyre qe anëtarët e KVV së, vëzhguesit e zgjedhjeve dhe përfaqësuesit e akredituar të mediave të mund ta shikoine tërë procesin e votimit dhe t'i shohin qarte kutitë e votimit gjate gjithë kohës.

Vëmendje: Vëzhguesit duhet të ulen prapa tavolinave të zyrtarëve të KVV (shih foton)

Shenjat duhet të vendosen në vende praktike për votues, me qëllim t'ju shërbejnë atyre për informim dhe edukim në Diten e Zgjedhjeve.

Vendosja e shenjave dhe e njoftimeve në vendvotim

Brenda vendvotimit:

-Shenjat e shigjetave për orientim (brenda VV-së).

-Vendos kabinat e votimit afër murreve në mënyrë që të sigurohet që votuesi mund të votojë në fshehtësi.

-Përgatit/Adapto një kabinë votimi më të ultë për të mundësuar votim të fshehtë për personat/votuesit në karrocë

-Broshura e kandidatëve (Në kabinë të votimit dhe mbi tavolinën e dhënësit të fletëvotimeve).

-Shenja për ndalimin e konsumimit të alkoolit

-Posterët "Si të shënohet fletëvotimi" (prapa kabinës së votimit dhe jashtë VV-ve).

-Shenja për "ndalimin e fotografimit të Fletevotimit"

Jashtë vendvotimit:

Njoftimet e mëposhtme duhet të ekspozohen kryesisht jashtë vendvotimit:

-Vendos mbi derë ose në hyrje të vendvotimit shkronjat e alfabetit të mbiemrave të votuesve të caktuar të votojnë në atë vendvotim. (p.sh. vendvotimi 1901/01 A-D) d.m.th. të gjithë votuesit cilëve mbiemri iu fillon me A deri në D, votojnë këtu.

-Vendos jashtë VV posterët me listën e kandidatëve që garojnë në zgjedhje për kuvende komunale

-Posterët "Si të shënohet fletëvotimi" (Në kabinë të votimit dhe jashtë VV-ve).

-Shenjat për "ndalimin e pirjes së duhanit" (jashtë VV-së).

-Shenjat për "ndalimin e armëve" (jashtë VV-së)

-Shenja për "ndalimin e publikimit- ekspozimit të Fletevotimit të votuar"

VENDVOTIMI

Renditja e KVV-ve dhe Vëzhguesve në Vendvotim

DITA E ZGJEDHJEVE

NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Në Ditën e Zgjedhjeve qendrat e votimit dhe vendvotimet duhet të jenë të përgatitura dhe gatshme për tu hapur në orën e përcaktuar zyrtarisht nga Komisioni.

- ZLKZ/KKZ janë përgjegjës për shpërndarjen e materialeve të ndjeshme Kryesuesve të vendvotimeve.
- Menaxherët e qendrave janë përgjegjës për rregullimin e qarkullimit brenda QV, sidhe udhëzimin e votesve brenda qendres për vendndodhjen e VV.
- Kryesuesit e VV janë përgjegjës për mbarëvajten e procesit të votimit brenda në vendvotim, duke siguruar proces të qetë përmes respektimit të drejtave të votuesve dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces. Kryesuesi së bashku me një zëvendëskryesues, obligohen që deri në ora ora 06:00 ta kenë pranuar dhe kontrolluar materialin e ndjeshëm dhe të nevojshëm për zgjedhje. Anëtaret tjerë të KVV janë të obliguar të paraqiten në vende te punes në mengjes në ora 06:00.

05:00-06:00 në mëngjes:

1. Kryesuesi kontrollon, verifikon dhe pranon materialin e ndjeshëm nga KKZ dhe siguron që asgjë nuk mungon
2. Nënshkruan formularin e KKZ për pranim të materialeve
3. Në përcellje të policisë transporton materialin në vendvotim.



06:00 - 07:00



1. Të gjithë anëtarët e KVV duhet të jenë prezent në vendvotimin e tyre në ora 06:00 të mengjesit.
2. Pranojnë materialet nga Kryesuesi
3. Rregullojnë vendvotimin sipas udhëzimeve në doracak
4. Shejojnë materialet me kodin e VV
5. Kryesuesi siguron se anëtaret i din detyrat dhe përgjegjësitë e tyre

NËSE: mungon materiali zgjedhor ose ndonjë anëtar i KVV - informo KKZ përmes Menaxherit të QV.

Do 00 deri ne mbyllje të QV

1. Hap QV me kohë dhe delegon detyrat te personeli teknik
2. Siguron se shenjat orientuese dhe udhëzimet për votues janë vendosur në vende praktike
3. Shpërndan materialet jo të ndjeshme tek Kryesuesit
4. Rregullon tavolinen ndihmëse
5. Raporton në KKZ: Mungesat e stafit ose materialit; hapjen/mbylljen e QV/VV; daljen e votuesve në zgjedhje



HAPJA E VENDVOTIMIT

Vendvotimi lejohet të hapet me një numër minimal prej tre (3) anëtarësh të KVV-së, por nuk mundë të funksionoj me me pak se 5 anetarë gjatë tërë procesit zgjedhor.

Kryesuesi duhet t'i kryej këto detyra para se ta hap vendvotimin zyrtarisht:

Plotëson në fletë të punës të FPR-së:

Plotëson pjesën e parë: shkruan numrin e VV; numrat e shiritave per mbylljen e kapakut te kutise se votimit. Shih mostrat e FPR-së.

- Verifikon dhe plotëson numrin total të fletëvotimeve të pranuara

Shkruan në Libër të votimit:

emrat dhe numrat personal të letërnjoftimeve të të gjithë anëtarëve të KVV-së;

emrat, mbiemrat dhe numrat personal të letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit (distinktivëve të vëzhguesve) të të gjithë vëzhguesve të akredituar te pranishëm.

Udhëzon KVV dhe vëzhguesit

Udhezon KVV të marrin materialet e nevojshme dhe të përgatiten për të filluar.

Vëzhguesve u rikujton obligimet dhe të drejtat e tyre si vëzhgues

Demonstron të pranishmive:

Tregon kutinë e zbrazët të votimit në prani të anëtarëve të KVV-ve dhe të gjithëve që janë të pranishëm në vendvotim.

Mbyll kutinë me shiritat mbyllës dhe të shënon numrat serik në FPR te pjesa përkatëse, nëse vec nuk janë shënuar në hapin paraprak.

Pas këtyre hapave dhe demonstrimeve Kryesuesi i KVV-së shpall hapjen e Vendvotimit dhe fillimin e procesit të votimit.

Orët e votimit janë: 07:00-19:00

PARA SE TË VOTON VOTUESI PARË

Kryesuesi dhe anëtaret e KVV-së mund të votojnë të paret, mirpo vetem pasi te hapet vendvotimi zyrtarisht, pra jo me heret se ora 7:00 (Rregulla Nr.09/2013-neni 19). Kryesuesi lejon që vetëm një anëtar i KVV të dal dhe votojë si i rregullt, por nëse anëtaret e KVV nuk janë duke shërbyer në QV ku zakonisht votojnë, mund të votojnë me kusht në vendvotimin e dyfishtë në QV ku do të punojnë në Diten e Zgjedhjeve.

IV PROCESI I VOTIMIT (07:00-19:00)

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E VOTIMIT

Llojet e Votimit

Ligji për zgjedhjet Lokale në Kosovë lejon këto lloje të votimit:

1) Votim të rregullt; 2) Votim me kusht; 3) Votim jashtë vendit - me postë (me kusht)
4) Votim për persona me nevoja dhe rethana të veçanta (me kusht)

VOTIMI I RREGULLT

VOTUESI

PERSONELI ZGJEDHOR (KVV)



VOTIMI ME KUSHT (NË VENDVOTIM TË DYFISHTË)

VOTUESI		PERSONELI ZGJEDHOR (KVV)
Votuesi/ja hyn në VV të duhur dhe tregon duart për ekzaminim	HAPI 1	Kontrolluesi/ja e rreshtit kontrollon nëse votuesi/ja ka votuar më herët, duke ekzaminuar duart e votuesit me llampë ultra vjollcë, për të parë nëse gishti i votuesit/es përmban ngjyrë të padukshme.
Votuesi/ja tregon dokumentin identifikues para zyrtarit/es të identifikimit	HAPI 2	Zyrtari/ja e identifikimit kërkon dokument identifikues të pranueshëm dhe Verifikon identitetin e votuesit duke krahasuar të dhënat QV, # personal dhe fotografinë në dokument identifikues.
Votuesi duhet të ketë dokument të pranueshëm identifikues, në të kundërten nuk lejohet të votoj Votuesi nënshkruan LVK dhe ZFK Nëse jo, nuk vazhdon.	HAPI 3	Shkruan të dhënat personale në Listë të Votuesve me Kusht (LVK) dhe e udhëzon ku të nënshkruhet Plotëson Zarfin e bardhë (ZFK) me të dhënat personale të votuesit dhe e udhëzon të nënshkruhet.
Votuesi/ja jep gishtin e djathtë tregues për spërkatje të ngjyres së padukshme, sidhe merr fletëvotimin	HAPI 4	Ia dorëzon dokumentin e identifikimit dhe ZFK-në e kompletuar. Dhënësit të fletëvotimeve (DhF). Dhënësi i Fletëvotimeve spërkat me ngjyrë gishtin e djathtë tregues të votuesit/es, e vulos fletëvotimin në pjesën e prapme, e palos sidhe ja jep votuesit/es.Për zgjedhje lokale lëshon dy fletëvotime (një për K. komunal dhe një për Kryetar të Komunave)
Votuesi/ja shkon në kabinën e zbrazët të votimit për të votuar fshehtas. Pasi të ketë votuar ai/ajo palos fletëvotimin dhe e vendos në zarf të fshehtësisë dhe më pas në ZFK; e mbyll zarfin dhe e hedh personalisht në kutinë e votave dhe del nga aty	HAPI 5	Mbikqyrësi i kutisë së votave kontrollon me sy a është fletëvotimi i vulosur; Jep zarfin e fshehtësisë dhe ZFK votuesit, hap kutinë që votuesi personalisht të hedh voten në kuti. Në fund ia kthen dokumentin identifikues votuesit.

Votimi me Kusht

Votimi me kusht dallon nga votimi i rregullt, sepse votat nuk numrohen në vendvotim, por në Qendër të Numërimit në Prishtinë. Formati i votimit përvec procedurave të rregullta, i ka disa procedura shtesë ngase kërkon të shkruhen të dhënat personale të votuesit në një pliko/Zarf i Fletëvotimeve me Kusht (ZFK), sidhe në Listë të Votuesve me Kusht (LVK) dhe në fund edhe fletëvotimi futet në një zarf të fshehtësisë, i cili futet në ZFK dhe hidhet në kutinë e votave me kusht që ndodhet vetëm në vendvotimin e dyfisht.

Votuesit votojnë me kusht në rastet kur për ndonjë arsye ata nuk plotësojnë kriteret e zotësisë juridike. Arsyet pse votuesi voton me kusht janë:

a) Votuesi nuk figuron/gjindet në LPV të vendvotimit apo te Lites së gjëre Komunale, por posedon dokument identifikimi të pranueshëm.

b) Në LPV pranë emrit, ndodhet ndonjë shenjë apo shkruan se votuesi duhet të votojë me kusht.

c) Votuesi në pamundësi të jet në vendvotimin që i është caktuar të votojë, voton me kusht në vendvotim të dyfisht në qendren ku ndodhet.

Mohimi i votimit me kusht (Rastet kur nuk duhet lejuar të votojnë me kusht)

a) Votuesi paraqitet në vendvotim të dyfishtë dhe në gishtat e votuesit është evidente prania e ngjyrës së padukshme.

b) Votuesi refuzon të nënshkruajë në Listën e Votuesve me Kusht (LVK).

c) Votuesi refuzon të nënshkruajë deklaratën në zarfin e fletëvotimit me kusht (ZFK)

d) Votuesi refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme.

e) Votuesi nuk ka DI te pranueshem.

f) Votuesi-pranë emrit te të cilit në LPV egziston një "SHENJË" (Vule), NUK MUND të votojë me kusht brenda Qendres se rregullt të Votimit, pasi që ata paraprakisht në periudhen e caktuar nga KQZ, kanë aplikuar në Zyrat e Komisionit Komunal Zgjedhor apo në institucionin përkates dhe janë regjistruar për të votuar si kategori e votuesve me nevoja te veçantaVPNV (votimi në shtëpi, në Qendren e paraburgimit, në Spital etj.).

Votimi me asistencë/ndihmës

Në kuader të votimit te rregullt hynë votimi me asistencë. Votuesi/ja mund të kërkoj ndihmë nga dikush që është jashtë vendvotimit për ti ndhmuar me votimin. Ndihmësi i zgjedhur nga votuesi i përgjigjet procedurave të votimit duke nënshkruar në LPV te emri votuesit/es dhe duke asistuar në kabinë të votimit.

Personeli Zgjedhor (KVV/Menaxheret, personeli teknik etj) nuk lejohen të ndihmojnë votuesin/en.

Këto raste shkruhen në libër të votimit nga Kryesuesi i cili duhet të mbajë evidencë të ndihmësve, sepse vetem njëherë ju lejohet të ndihmojnë.

KUJDES: Votimi Familjar/ votimi për dikë tjetër pa vullnetin e votuesit është e ndaluar me ligj, andaj çdo votues ka të drejtë të votoi i lirë, i pandikuar dhe në fshehtësi në kabinë të votimit

VOTIMI ME POSTË (JASHTË VENDIT)

Votimi jashtë vendit me postë mundëson votuesve që plotësojnë kriteret ligjore, por që ndodhen jashtë vendit/Kosoves të votojnë përmes postes. Procesi parasheh që votuesi duhet të aplikoj në SKQZ për tu futur në listë të votuesve jashtë vendit; më pas të verifikohet rasti dhe nëse votuesi/ja plotëson kriteret i konfirmohet e drejta për të votuar. Votuesit që regjistrohen suksesshëm, hiqen/shlyhen apo shejohen në LPV në Kosovë me vulë. Votuesi mund të shkarkoj fletëvotimin nga ueb faqja e KQZ, të votojë, dhe ta fut në zarf së bashku me një dokument identifikimi. Afati ligjor parasheh që votat me postë të pranohen nga KQZ 24 orë para Dites së Zgjedhjeve



VOTIMI PËR PERSONAT ME NEVOJA DHE RRETHANA TË VEÇANTA

Ky lloj votimi mundëson votuesve që për arsye të ndryshme të cekura në Ligj dhe Rregull nuk mund të jenë në vendvotim të rregullt në Diten e Zgjedhjeve, të votojnë në vendin ku ndodhen. Procesi parasheh regjistrim paraprak të votuesve në SKQZ. Votuesit që regjistrohen suksessshëm futen në listë/regjister votimi dhe në Diten e Zgjedhjeve nga ora 09:00 - 21:00 ekipet mobile të KKV i shërbejnë të gjithë votuesit e regjsitruar dhe që plotësojnë kriteret ligjore për këtë kategori.

Votuesit e paraparë në këtë kategori janë siç vijojnë:

a **Votuesit e ngujuar në shtëpi:** votuesit me zotësi juridike të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;

b **Votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion:** votuesit me zotësi juridike në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit, ose

c **Votuesit në rrethana të veçanta:** votuesit me zotësi juridike që jetojnë në bashkësitë, të cilët për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ).

Më shumë informata në Rregullen Zgjedhore Nr. 04/2013

Procesi dhe procedurat e votimit për këto kategori është si në vijim:

VOTIMI PËR VOTUESIT E NGUJUAR NË SHTËPI DHE NË RRETHANA TË VEÇANTA

VOTUESI	PERSONELI ZGJEDHOR (KVVEL)
Votuesi/ja ka kryer aplikimin me afat dhe është regjistruar me sukses që të votojë nga shtëpia apo nga aty ku ndodhet	HAPI 1 — Në Diten e Zgjedhjeve KKZ do të themelon Këshillat e VV Ekipet Levizes (KVVEL) që do të përbëhen nga 3 zyrtarë. Kryesuesi bashkë me dy anëtarë do të pranoj materialet e ndjeshme nga KKZ dhe listen e personave që do ti viziton sipas orarit 09:00 21:00, për t'iu mundësuar votimin nga shtëpitë.
Votuesi/ja tregon duart për egzaminim	HAPI 2 — Kontrolluesi/ja e rreshtit kontrollon nëse votuesi/ja ka votuar më herët, duke ekzaminuar duart e votuesit me llampë ultra vjollcë, për të parë nëse gishti i votuesit/es përmban ngjyrë të padukshme.
Votuesi duhet të ketë dokument të pranueshëm identifikues, në të kundërten nuk lejohet të votoj. Votuesi nënshkruan LVK dhe ZFK Nëse jo, nuk vazhdon	HAPI 3 — Zyrtari/ja e identifikimit kërkon dokument identifikues të pranueshëm dhe Verifikon identitetin e votuesit Shkruan të dhënat personale në Listë të Votuesve me Kusht (LVK) dhe e udhëzon ku të nënshkruhet Plotëson Zarfin e bardhë (ZFK) me të dhënat personale të votuesit dhe e udhëzon të nënshkruhet.
Votuesi/ja jep gishtin e djathtë tregues për spërkatje të ngjyres së padukshme, sidhe merr fletëvotimin	HAPI 4 — Dhënësi i Fletëvotimeve spërkat me ngjyrë gishtin e djathtë tregues të votuesit/es. e vulos fletëvotimin në pjesën e prapme. e palos sidhe ja jep votuesit/es.
Votuesi/ja shkon në kabinën e zbrazët të votimit për të votuar fshehtas. Pasi të ketë votuar ai/ajo palos fletëvotimin dhe e vendos në zarf të fshehtësisë dhe më pas në ZFK; e mbyll zarfin dhe e hedh personalisht në kutinë e votave dhe del nga aty	HAPI 5 — Mbikqyrësi i kutisë së votave kontrollon me sy a është fletëvotimi i vulosur; Jep zarfin e fshehtësisë dhe ZFK votuesit, hap kutinë që votuesi personalisht të hedh voten në kuti. Në fund ia kthen dokumentin identifikues votuesit

VOTIMI NË INSTITUCIONE

Votimi në institucione shërben për votuesit të cilët kanë lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion. Në këtë kategori hynë votuesit me zotësi juridike në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit

INSTITUCIONI — **Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ)**

Administrata e institucionit evidenton dhe përgatit listen me të gjithë votuesit 15 ditë para Dites së Zgjedhjeve.

HAPI 1

a) KKZ identifikon institucionet në Komunë dhe bashkëpunon me institucionet përkatëse sipas marrëveshjes dhe ligjit për evidentimin e votuesve për të formuar listen e votuesve në institucione.
b) Formon ekipet e votimit në institucione (EVI)
c) Përcakton formatin e votimit, vendvotim fiks apo ekip lëvizës që shërben votuesit një nga një.

VOTUESI — **PERSONELI ZGJEDHOR (KVVEL)**

Votuesi/ja është regjistruar në listë të Institucionit me sukses që të votojë

HAPI 2

Në Diten e Zgjedhjeve KKZ do të themelon Këshillat e VV Ekipet e Votimit në Institucione (EVI) që do të përbëhen nga 3 zyrtarë. Kryesuesi bashkë me dy anëtarë do të pranoj materialet e ndjeshme nga KKZ dhe listen e personave që do ti viziton sipas orarit 09:00-21:00, për t'iu mundësuar votimin nga shtëpitë.

Votuesi/ja tregon duart për egzaminim

HAPI 3

Kontrolluesi/ja e rreshtit kontrollon nëse votuesi/ja ka votuar më herët, duke ekzaminuar duart e votuesit me llampë ultra vjollcë, për të parë nëse gishti i votuesit/es përmban ngjyrë të padukshme.



V MBYLLJA E VENDVOTIMIT

MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT

Në orën 19:00, menaxheri i QV-së është përgjegjës të sigurojë se asnjë votues tjetër të mos hyjë në rreshtat e QV-së. Derisa ka votues në QV, vendvotimet mbesin të hapura. Dera kryesore e QV mbyllet, por vendvotimet mbesin të hapura për të siguruar që në rast se ndonjë votues ka gabuar vendvotimin të ketë mundësi të votojë aty ku është caktuar zyrtarisht.

MBYLLJA E VENDVOTIMIT (19:00)

Kryesuesi i KVV-së është përgjegjës për mbylljen e vendvotimit në orën e përcaktuar zyrtarisht nga KQZ (19:00). Kryesuesi i KVV bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjegjes për këto detyra:

Detyrat e menjëhershme:

1. Kryesuesi shikon jashtë vendvotimit a ka votues dhe konsultohet me Menaxherin e QV për të kuptu a ka votues brenda në QV.
2. Nese Menaxheri konfirmon se nuk ka votues, Kryesuesi udhëzon Kontrolluesin e rreshtit ta mbyll derën dhe shpall vendvotimin zyrtarisht të mbyllur.

- Mbyll vrimen e kapakut të kutisë së votimit me shirit mbyllës dhe e shkruan numrin e shiritit në Formular të rezultateve (FPR) dhe në libër të votimit.
- Shkruan në librin e votimit kohën e mbylljes së vendvotimit dhe emrat e personave të pranishëm në vendvotim dhe i informon se nëse largohen nga VV-ja para se të përfundojë numërimi, ata nuk do të lejohen të kthehen-(pos anetareve të KVV-së për nevoja fiziologjike).

Udhëzim: Pas mbylljes së vendvotimit, Kryesuesi i KVV-së nuk do të lejon askënd të hyn brenda, përveç Zyrtarëve të autorizuar si: Anëtaret e KQZ, KKZ, Trajnerët e Sekretariatit Kryesuesi monitoron të gjithë personat qe hyjnë dhe largohen nga vendvotimi.

Detyrat para se të hapet kutia e votave

Para se të hapet kutia e votave, Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV do të kryejnë këto detyra:

1. Numëron nënshkrimet e votuesve në LPV dhe (në LVK nëse vv i dyfishtë) dhe shuma e nënshkrimeve shkruhet në pjesën përkatëse të fletës punuese të formularit të përputhjeve të rezultateve (FPR)
2. Numëron fletëvotimet e papërdorura-TË MBETURA dhe shuma e tyre shkruhet në pjesën përkatëse të fletës punuese të FPR-së
3. Fletëvotimet e papërdorura paketohen së bashku me amat e fletëvotimeve në thesin 2 (të mos mbyllet ende).
4. Numërohen fletëvotimet e dëmtuara dhe shuma e tyre shkruhet në pjesën përkatëse të fletës punuese të formularit të përputhjeve të rezultateve (FPR)
5. Fletëvotimet e dëmtuara palohen dhe shuma totale e tyre shkruhet në një pusull. Fletëvotimet e dëmtuara paketohen në zarfin 1 dhe në të shënohet shuma/sasia e fletëvotimeve.

6. **Përgatitjet për numërim të votave:**

- Vendosni tavolinat në forme të shkronjes "T" në atë mënyrë që vëzhguesit e akredituar te mund të shohin qartë tërë procesin e numrimit.
- Përgatitni hapësirën e punës për numërim (hiqni nga tavolinat të gjithë stilolapsat, lapsat dhe materialet e tjera).

Në rast të mospërputhjeve, çdo gjë rinumërohet nga një anëtar tjetër i KVV, sepse para se të bartën të dhënat në formular të rezultateve, Kryesuesi është i obliguar të siguron saktësinë e të dhënave.

Vetëm Kryesuesi është i autorizuar të shkruan në FPR dhe në fletë pune të FPR-së.

VI NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE DHE PËRPUTHJA E REZULTATEVE

HYRJE NË PROCEDURA TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Kutitë e votimit duhet të hapen një nga një dhe të procedohen/numërohen si më poshtë:

1. Votimi me kusht (vetëm në vendvotim të dyfishtë)
2. Zgjedhjet për Kryetar Komune
3. Zgjedhjet për Kuvende të Komunave

Në vendvotimin ku votohet vetëm me fletëvotime të rregullta, filloni me numërimin e fletëvotimeve për Kryetar të Komunës pastaj numërimi i fletëvotimeve për Kuvend Komunal. Numërimi i votave është proces shumë i rëndësishëm dhe i ndjeshëm sepse ndikon drejtpërdrejt në integritetin dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor. Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë duhet të punojnë me profesionalizëm dhe kompetencë të lartë

Në vijim prezantojmë parimet dhe rregullat univerzale ndërkombtare lidhur me numërimin dhe përputhshmërinë e rezultateve e që poashtu vlejnë dhe janë të aplikueshme edhe në Kosovë.

KUJDES: FALSIFIKIMI, MANIPULIMI I VOTAVE GJATË NUMËRIMIT PARAQET SHKELJE TË RËNDË / VEPËR PENALE DHE MUND TË DËNOHET ME BURGIM NGA 3 DERI NË 5 VITE.

Përputhja 1:



Numri total i nënshkrimeve në LPV

=



Numri total i fletëvotimeve brenda në kuti të votave

Përputhja 2:



Numri total i fletëvotimeve brenda në kuti të votave

+

Numri total i fletëvotimeve të papërdorura

+

Numri total i fletëvotimeve të dëmtuara

=

Numri total i fletëvotimeve të pranuara (dorëzuar nga KKZ)

Përputhja 3:

Numri total i fletëvotimeve brenda në kuti të votave

NUMËRIMI I ZARFEVE ME KUSHT NË VENDVOTIM TË DYFISHTË

Në vendvotim të dyfishtë. Kryesuesi fillon procesin e numërimit të votave duke hapur Kutinë me zarfet e votave me kusht (ZFK) të paren.
Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

Hapi 1:

- Përgatit tavolinat dhe hapsirën ku do të numërohen votat duke lënë qasje për vëzhguesit
- Largon lapsat dhe gjërat tjera nga tavolina numërimit
- Kryesuesi vendos personelin e KVV në pozitat e tyre
- Sjell kutinë e votave (ZFK) mbi tavolinë dhe lexon numrat e shiritave të sigurisë dhe i krahason me numrat e shkruar në FPR ose në libër të votimit.

Hapi 2:

- Kryesuesi pren shiritat anësor të kutisë së votave me kusht dhe i vendos në një vend të sigurt
- Zbraz zarfet me kusht mbi tavolinë dhe i numëron dy herë
- Kryesuesi shkruan shumën totale të zarfeve me kusht në formular të përputhjeve të rezultateve (FPR)

Shënim: nëse vërren ndonjë ZFK të zprazët e numëron si të rregullt. Nëse vërren fletëvotim apo zarf të fshehtësisë jashtë Zarfit të Votave me Kusht (ZFK) e shkruan në libër të votimit.

Hapi 3:

- Kryesuesi krahason a përputhet shuma totale e nënshkrimeve në Listë të votuesve me kusht (LVK) me shumën totale të zarfeve me kusht brenda në kuti

Numri total i nënshkrimeve në LVK

Shumën totale të ZFK brenda në kuti

NUMËRIMI I VOTAVE PËR KRYETAR KOMUNE

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

Hapi 1:

- Përgatit tavolinat dhe hapsirën ku do të numërohen votat duke lënë qasje për vëzhguesit
- Largon lapsat dhe gjërat tjera nga tavolina numërimit
- Kryesuesi vendos personelin e KVV në pozitat e tyre
- Sjell kutinë e votave mbi tavolinë dhe lexon numrat e shiritave të sigurisë dhe i krahason me numrat e shkruar në FPR ose në libër të votimit.

Hapi 2:

- Kryesuesi pren shiritat anësor të kutisë së votave dhe i vendos në një vend të sigurt
- Zbraz fletëvotimet mbi tavolinë dhe i klasifikon në: **të vulosura** dhe **të pavulusora**
- Kryesuesi mbikqyrë procesin kur katër (4) anëtarë numërojnë fletëvotimet duke i paluar në dëngje me nga 50 fletëvotime. Çdo deng me 50 fletëvotime numërohet dy (2) herë nga anëtarë të ndryshëm të KVV, për të konfirmuar dhe siguruar se numri është i saktë.
- Kryesuesi mbledhë numrin apo shumën totale të fletëvotimeve dhe e shkruan në formular të përputhjeve të rezultateve (FPR) përkatës.

Shënim: nëse ka fletëvotime të pavulosura, numërohen dhe shkruhen në libër votimi. Cdo fletëvotim i gjetur në kuti të votave i pavulosur cilësohet i pavlefshëm.

Hapi 3:

- Kryesuesi krahason shumën totale të nënshkrimeve në LPV, të shkuar në FPR me shumën totale të fletëvotimeve në kuti të votave (Përputhja 1)

Shënim: Numri i nënshkrimeve në LPV duhet të përputhet me saktësi me shumen totale të fletëvotimeve në kuti të votave: por nëse ka mospërputhje, atëherë ajo duhet të shrkuhet në FPR dhe të sqarohet në libër të votimit.

Nëse ka mospërputhje, pranohet toleranca e mospërputhjes si në vijim:

- Deri në 100 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 1 (+/-)
- Deri në 200 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 2 (+/-)
- Më shumë se 200 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 3 (+/-)

Hapi 4:

Kthen fletëvotimet mbarë dhe i klasifikon në:



Hapi 5:

- Ndaj fletëvotimet sipas kandidatëve.
- Merr dengun e fletëvotimeve të kandidatit të parë dhe numroj votat e fiturara.
- Numro çdo deng dy herë përmes dy anëtarëve të ndryshëm të KVV-së për të vërtetuar saktësinë

Shënim: Nëse nga dy numrimet, shuma e votave është e njejtë, vazhdohet me dengun e radhës. Ndërsa nëse shuma nuk përputhet, atëherë dengu rinumrohet përsëri.

- Procesi vazhdon deri kur numërohen të gjitha fletëvotimet
- Kryesuesi shkruan në FPR votat totale për secilin kandidat
- Kryesuesi mbledhë votat e fituara nga gjithë kandidatët dhe shumën totale e shkruan në FPR përkatës.
- Kryesuesi kontrollon të dhënat dhe sigurohet se është arrit përputhja 3.

UDHËZIM: KRYESUESI INFORMON ZYRTARIN PËR REZULTATET PRELIMINARE (K-VOTE) PËR REZULTATET DUKE JA DHËNË KOPJEN E VERDHË TË FPR-së.



- Paketon materialet sipas udhëzimeve, por nuk i mbyll në këtë fazë

NUMËRIMI I VOTAVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Kryesuesi bashkë me anëtarët tjerë të KVV janë përgjegjës për këto detyra:

Hapi 1:

- Përgatit tavolinat dhe hapsirën ku do të numërohen votat duke lënë qasje për vëzhguesit
- Largon lapsat dhe gjërat tjera nga tavolina numërimit
- Kryesuesi vendos personelin e KVV në pozitat e tyre
- Sjell kutinë e votave mbi tavolinë dhe lexon numrat e shiritave të sigurisë dhe i krahason me numrat e shkruar në FPR ose në libër të votimit.

Hapi 2:

- Kryesuesi pren shiritat anësor të kutisë së votave dhe i vendos në një vend të sigurt
- Zbraz fletëvotimet mbi tavolinë dhe i klasifikon në: të vulosura dhe të pavulosura
- Kryesuesi mbikqyrë procesin kur katër (4) anëtarë numërojnë fletëvotimet duke i paluar në dëngje me nga 50 fletëvotime. Çdo deng me 50 fletëvotime numërohet dy (2) herë nga anëtarë të ndryshëm të KVV, për të konfirmuar dhe siguruar se numri është i saktë.
- Kryesuesi mbledhë numrin apo shumën totale të fletëvotimeve dhe e shkruan në formular të përputhjeve të rezultateve (FPR)

Shënim: nëse ka fletëvotime të pavulosura, numërohen dhe shkruhen në libër votimi. Cdo fletëvotim i gjetur në kuti të votave i pavulosur cilësohet i pavlefshëm.

Hapi 3:

- Kryesuesi krahason shumën totale të nënshkrimeve në LPV, të shkuar në FPR me shumën totale të fletëvotimeve në kuti të votave (Përputhja 1)

Shënim: Numri i nënshkrimeve në LPV duhet të përputhet me saktësi me shumen totale të fletëvotimeve në kuti të votave; por nëse ka mospërputhje, atëherë ajo duhet të shrkuhet në FPR dhe të sqarohet në libër të votimit.

Nëse ka mospërputhje, pranohet toleranca e mospërputhjes si në vijim:

- Deri në 100 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 1 (+/-)
- Deri në 200 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 2 (+/-)
- Më shumë se 200 nënshkrime në LPV, tolerohet mospërputhje 3 (+/-)

Hapi 4:

Kthen fletëvotimet mbarë dhe i klasifikon në:

Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse:

- Preferenca e votuesit për subjektin politik është e paqartë
- Është votuar për më shumë se një subjekt politik.
- Nëse nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimit.
- Nuk është votuar për subjektin politik, dmth mungon shenja për subjektin politik, por janë votuar vetëm kandidatët.

Në rastet kur anëtaret e KVV nuk pajtohen, vendimi i Kryesuesit është përfundimtar. Kryesuesi informon të pranishmit për të drejten e tyre për tu ankuar pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Hapi 5:

- Ndaj fletëvotimet sipas subjekteve politike në dengje, duke i rradhitur sipas rradhitjes në fletëvotim.
- Merr dengun e fletëvotimeve të subjektit të parë politik dhe numëroj votat e fituara për subjektin politik.
- Numëro çdo deng dy herë përmes dy anëtarëve të ndryshëm të KVV-së për të vërtetuar saktësinë.

Shënim: Nëse nga dy numërimet, shuma e votave është e njejtë, vazhdohet me dengun e radhës. Ndërsa nëse shuma nuk përputhet, atëherë dengu rinumërohet përsëri.

- Procesi vazhdon deri kur numërohen të gjitha dengjet e fletëvotimeve nga subjektet politike

- Kryesuesi shkruan në FPR votat totale për secilin subjekt politik
- Kryesuesi mbledhë votat e fituara nga gjitha subjektet politike dhe shumën totale e shkruan në FPR.
- Kryesuesi kontrollon të dhënat dhe sigurohet se është arrit përputhja 3.

UDHËZIM: KRYESUESI INFORMON ZYRTARIN PËR REZULTATET PRELIMINARE (K-VOTE) PËR REZULTATET DUKE JA DHËNË KOPJEN E VERDHË TË FPR-së.



NUMËRIMI I VOTAVE TË KANDIDATËVE

Kryesuesi bashkë më anëtarë tjerë të KVV, janë përgjegjës të numrojnë votat e kandidatëve dhe ti regjistrojnë/shkruajnë në formular të përputhjes së rezultatave për kandidatë (FRK)

Hapi 1:

- Kryesuesi nxjerr materialin e nevojshmëm si: Formulari i Votave të Kandidatëve, Fletat që shërbejnë për regjistrim të votave të kandidatëve (të njohura si FLLK), stilolaps të kaltër
- Rifreskon procedurat dhe sqaron detajsiht si do të përdoren
- Kryesuesi cakton dy (2) anëtarë si LEXUES dhe dy (2) si REGJISTRUES (shkruajnë votat në FLLK)
- Sqaron si do të regjistrohen votat në FLLK
- Kryesuesi udhëzon ekipin ti palojnë fletëvotimet në dengje me nga 25.
- Votat do të lexohen nga një 1 Lexues, ndërsa 2 Regjistrues do të shkruajnë votat në FLLK. Pas përfundimit të dengut (25) Kryesuesi krahason a përputhën votat e kandidatëve në dy FLLK. Nëse gjen mospërputhje në fletëvotime, dengu me 25 fletëvotime delegohet dhe lexohen nga Lexuesi 2.

Shënim: Në dengun prej 25 fletëvotimeve, kandidati mund ti ketë maksimum 25 vota, jo më shumë.



Hapi 2:

- Kryesuesi sjellë në tavolinë fletëvotimet e subjektit të parë politik (sipas rradhitjes në fletëvotim)
- Katër anëtaret e KVV i ndajnë fletëvotimet në dengje me nga 25 fletëvotime.

Udhëzim: 1 Lexues lexon votat e fituara, ndërsa 2 regjistrues i shkruajnë në FLLK

- Lexuesi merr 25 fletëvotime dhe fillon të lexon me zë votat.
- 2 regjistrues i shkruajnë votat e fituara nga secili kandidatët në FLLK
- Kryesuesi kontrollon a përputhën votat e kandidatëve të shkruara në dy FLLK e regjistruesve
- Nëse ka mospërputhje në mes regjistruesve, lexuesi 2 i lexon votat ndërsa regjistruesit i ri-shkruajnë në FLLK.
- Kur përfundojnë dengun, pranojnë dengun tjetër

Hapi 3:

- Kryesuesi mbledh votat për secilin kandidat dhe shumën totale e shkruan në Formular të Rezultateve të Kandidatëve (FRK)
- Sjell fletëvotimet e subjektit të dytë me radhë dhe përsëritet procesi i cekur në hapin 2.

Hapi 4:

- Kur numërohen të gjitha fletëvotimet për subjektet politike, më pastaj Kryesuesi shkruan edhe votat e kandidatëve në FRK dhe kërkon nga anëtarët e KVV ta nënshruajnë Formularët e Rezultateve.
- Pasi ti plotëson FPR-të dhe FRK, shkëput kopjen me ngjyrë pembe dhe e vendos në muri tek dera jashtë të VV, si informim për të pranishmit.
- Kopjen e verdhë të FPR për Kryetar Komune dhe FPR për Kuvendin Komunal Kryesuesi I Vendvotimit i'a dorëzon Menaxherit të QV/personelit, dhe Menaxheri I QV ketë kopje I'a dorëzon stafit që bejnë futjen e të dhënave për rezultatet preliminare (K-VOTE).

Kryesuesi siguron që:

- Shkruan/plotëson në FRK (000) për kandidatët të cilët nuk kanë fituar asnjë votë
- Çdo Fletë Llogaritëse duhet të ketë të plotësuar: Emrin dhe numrin e subjektit
- Çdo Fletë Llogaritëse e përdorur nga Regjistruesi duhet të jetë e nënshkruar nga regjistruesi sidhe ta përmbajë emrin dhe mbiemrin e regjistruesit me shkronja të shtypit
- Një FLLK mund të regjistrojë maksimum 200 vota të kandidatit, por nëse kandidati fiton më shumë se 200 vota, regjistruesit përdorin FLLK e dytë për atë subjekt politik.

VII FORMULARËT E REZULTATEVE

Pas përfundimit të numërimit të votave, Kryesuesi i KVV i shkruan rezultatet e votave në formular të përputhjes së rezultateve dhe në formularë të rezultateve për kandidatë.

Formularët që përdoren për regjistrimin e rezultateve të zgjedhjeve lokale janë:
1. Formulari i Përputhjes së Rezultateve për Kryetarë të Komunave (FPR)
2. Formulari i Përputhjes së Rezultateve për Kuvende të Komunave (FPR)
3. Formulari i Rezultateve të Kandidatëve (FRK)

Plotësimi i Formularve
Çdo formular përmban një fletë pune. Kryesuesi gjatë procesit të numërimit do të shkruan në fletë pune dhe vetëm kur vërteton se të dhënat janë saktë, i bart në FPR origjinale.
Në fund, Kryesuesi komunikon/prezanton rezultatet e vendvotimit duke shkëputur kopjen pembe të FPR dhe duke e vendosur diku në murr brenda vendvotimit për tju mundësuar vëshguesve qasje në rezultate zyrtare të vendvotimit. Kopja e verdhë e FPR-së, shkëputet dhe i dorëzohet Menaxherit të QV, apo personelit për futjen e rezultateve preliminare në QV (K-Vote).

